

**PROPOZIM - ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA FUSHA**


EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE

KLASA II



KLASA II

EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE



EDUKIMI MEDIATIK DHE KULTURA MEDIATIKE NË MËSIMIN KLASOR

- Doracak për mësimdhënësit e klasës II -

Botues: Instituti Maqedonas i Mediave
Rr. „Jurij Gagarin“, 17/1-1
1000 Shkup

Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Rr. „Rugjer Boshkoviq“, nr. 20
1000 Shkup

Redaktorë: Mitko Çeshllarov
Ajshe Ajrullai

Autorë: Marina Dimitrieva-Gjorgjievska
Mihajllo Llahtov
Olivera Todoroska
Mitko Çeshllarov
Ajshe Ajrullai

Përkthimi: Vjosa Taipi

Redaksia profesionale: Mihajllo Llahtov
Vesna Nikodinoska

Lektura: Shpëtim Hiseni

Dizajni dhe përpunimi teknik: Koma Dizajn

Doracaku është përgatitur në kuadër të Projektit të USAID-it për edukim mediatik “Të rinjtë mendojnë”, të cilin e realizojnë IREKS dhe partnerët lokalë: Instituti Maqedonas i Mediave, Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Forumi Arsimit Rinor, në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Mbështetje për përgatitjen e doracakat është siguruar nga populli amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja e Doracakat është përgjegjësi e IREKS-it dhe Institutit Maqedonas të Mediave (MIM) dhe nuk i paraqet qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.





Hyrje

Sot, në kohën e “realitetit të ri mediatik”, kur të rinjtë çdo ditë janë të ekspozuar në një numër të madh të informacioneve, përmes platformave dhe teknologjive mediatike tradicionale dhe sidomos digjitale, është e domosdoshme që përmes arsimit, në shkollë, ata të pajisen me dije dhe shkathtësi për analizim kritik të përmbajtjeve mediatike. Është e nevojshme që nxënësit të mund të kufizojnë “kryesoren dhe krahasimin” në gjithçka që lexojnë, dëgjojnë dhe shohin, t’i njohin elementët e propagandës ose porosinë e fshehta reklamuese, të njohin gjuhën implicite dhe eksplicite të urrejtjes. Përmes mësim, nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzim efikas të informacioneve dhe përmbajtjeve mediatike dhe platformave, ndërsa përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në mediat e ndryshme sociale, pritet që të veprojnë me përgjegjësi dhe në mënyrë kritike t’i qasen përmbajtjes të cilën e “krijojnë”.

Në këtë drejtim aplikohet arsimimi për edukimin mediatik në programet e reja mësimore me rezultate të caktuara nga mësimi, përmbajtjet, standardet për vlerësim dhe shembuj të aktiviteteve, me arritjen dhe realizimin e të cilëve nxënësit më me përgjegjësi do t’u qasen mediave, do t’i analizojnë porosinë dhe do t’i vlerësojnë informacionet të të cilat arrijnë, do t’i shfrytëzojnë informacionet që i marrin përmes mediave dhe vet do të krijojnë porosi mediatike në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.

Në programet mësimore nga klasa e parë deri në të pestën në arsimin fillor, mësimi i edukimit mediatik është i integruar në një numër të madh të përmbajtjeve dhe aktiviteteve përmes lëndëve të ndryshme mësimore. Kështu që, në kuadër të programit mësimor të lëndëve Gjuhë Maqedonase, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Turke, Gjuhë Serbe dhe Gjuhë Boshnjake, është përgatitur kapitull i posaçëm i titulluar *Edukimi mediatik dhe kultura mediatike*.

Për arritjen e suksesshme të rezultateve nga mësimi i përcaktuar në këtë kapitull të programit mësimor, është e nevojshme që të realizohen aktivitete cilësore dhe kreative në orë, përmes të cilave nxënësit me përvojë do të “edukohen” dhe do të mësojnë për mediat dhe rolin e tyre.

Doracaku për mësimdhënës, të cilët realizojnë mësim në lëndët Gjuhë Maqedonase, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Turke, Gjuhë Serbe dhe Gjuhë Boshnjake do t’u ndihmojë mësuesve klasorë gjatë planifikimit dhe realizimit të orëve, në të cilat përpunohen përmbajtjet e edukimit mediatik dhe kulturë mediatike. Doracaku është përgatitur me qëllim që të jetë mbështetje dhe inspirim në punën e mësimdhënësve për realizimin e mësimin të suksesshëm dhe kreativ.

Çdo shembull për realizimin e aktiviteteve në orë ka të bëjë me një përmbajtje të caktuar, e lidhur me standardet përkatëse për vlerësim nga programi mësimor që duhet të arrihet përmes aktiviteteve në orë. Gjithashtu, janë renditur edhe pajisjet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve gjatë orës.

Shembujt në orë janë zhvilluar përmes aktiviteteve për pjesën hyrëse, kryesore dhe përfundimtare të orës. Qëllimi i aktiviteteve hyrëse është t’i aktivizojnë paradijet e nxënësve

dhe t'i udhëzojnë për përmbajtjen. Në të shumtën e rasteve janë të konceptuara përmes hulumtimeve të shkurtra ose përmes diskutimeve me qëllim që të sqarojnë ose të "ndihen" shembujt që do të përpunohen në orë. Në pjesën që ka të bëjë me aktivitetet nga Pjesa kryesore e orës mësimore, është dhënë përshkrim i detajuar i aktivitetit/aktiviteteve, përmes të cilit/ të cilëve nxënësit do të hulumtojnë dhe pastaj me përvojë do të mësojnë, si dhe propozim për mënyrën e organizimit të punës së nxënësve në grupe dhe në çifte. Aktivitetet kryesore për orët në doracak ofrojnë diapazon të gjerë të ideve për mësim dhe për veprim kreativ. Ndërkaq, aktivitetet përmblylëse janë të drejtuara nga nxjerrja e konkluzioneve përmes diskutimeve të realizuara. Pjesa e fundit e shembujve për orët është reflektim, në të cilin janë ofruar pyetje për atë se çfarë kanë mësuar nxënësit, rezyme dhe lidhshmëri mes të mësuarës me jetën e tyre të përditshme.

Mësimdhënësit mund t'i shfrytëzojnë shembujt për realizimin e orëve për edukim mediatik nga doracaku si ide për aktivitete, përmes të cilave do të arrihen standardet për vlerësim gjatë realizimit të përmbajtjeve të lartpërmendura nga programi mësimor në gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe, gjuhën turke, gjuhën serbe dhe gjuhën boshnjake. Aktivitetet mund të ndërmerren ashtu si janë dhënë, mund të përshtaten ose të ndryshohen, përkatësisht të modifikohen në përputhje me idetë e mësimdhënësit, nevojat dhe interesat e nxënësve dhe përparimin e tyre në procesin e mëimit, pajisjet e disponueshme për punë, kushtet në shkollë etj. Ato paraqesin shembuj për mësim kreativ dhe praktik për edukimin mediatik sipas programeve të reja mësimore. Në bazë të këtyre shembujve, mësimdhënësit lehtë mund të zhvillojnë skenarë për realizimin e orëve, varësisht nga ambienti dhe kushtet në të cilat e realizojnë mësimin. Në mënyrë shtesë, mësimi i integruar mundëson që disa nga standardet dhe aktivitetet për arritjen e tyre, të lidhen edhe me përmbajtje të ngjashme të përfshira në lëndë të tjera.

Pritet që ky doracak, përveç që do të mbështetet nga mësimdhënësit gjatë planifikimit dhe realizimit të mëimit, në të njëjtën kohë të jetë edhe nxitje për kreativitet më të madh, motivim dhe entuziazëm në punë.

Udhëzim për mësimdhënësin/mësimdhënësen për shfrytëzimin e Doracakt për Edukim Mediatik për klasën II

Më shumë informacione për termat e rinj dhe konceptet thelbësore, mësimdhënësi mund të lexojë në Fjalorin e fushës së edukimit mediatik, që është pjesë e këtij doracaku. Në këtë mënyrë, mësimdhënësi do të mund t'i aftësojë përmbajtjet sipas moshës së nxënësve dhe më lehtë mund t'ua transmetojë, me qëllim që ata t'i kuptojnë.

KLASA II

EDUKIMI MEDIATIK DHE KULTURA MEDIATIKE

Sipas planit mësimor për lëndën Gjuhë Maqedonase për klasën e dytë, nga lëmi Edukim Mediatik dhe Kulturë Mediatike mësohen si vijon:

Përmbajtje (dhe nocione)

- Llojet e mediave (media e shkruar, media elektronike [TV dhe radio], media onlajn);
- Llojet e mesazheve mediatike (raportim, udhëzim, reklamë);
- Interpretimi dhe përdorimi i përmbajtjes mediatike;
- Krijimi i mesazheve dhe përmbajtjeve mediatike.

Në fund të vitit shkollor, nxënësit në këtë fushë duhet të arrijnë:

Rezultate nga mësimi

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/e aftë të:

1. dallojë dhe tregojë lloje të ndryshme të mediave;
2. kuptojë mesazhet mediatike dhe të bëjë dallimin ndërmjet raportimit, reklamimit dhe dhënies së udhëzimeve;
3. identifikojë dhe interpretojë informacione dhe mesazhe në përmbajtje tekstuale, figurative dhe digjitale për njoftim, udhëzim dhe reklamim;
4. krijojë mesazhe të shkurtra mediatike për raportim, udhëzim dhe reklamim.

Lista e nocioneve në fushën e Edukimit Mediatik¹

Medium ↘ Mjetet bazë të komunikimit masiv përmes së cilave transmetohen mesazhet dhe përmbajtjet, si interneti, radioja, televizioni dhe shtypi. Fjala rrjedh nga fjala latine *medium*, që do të thotë diçka në mes, dhe i referohet mediumit përmes së cilit informacioni transmetohet nga dërguesi tek marrësi.

Reklama ↘ Prezantimi publik i një produkti, shërbimi ose aktiviteti që nxjerr në pah vetitë e produktit të reklamuar për të tërhequr vëmendjen e konsumatorëve ndaj tij dhe për të inkurajuar blerjen e tij. Prezantimi mund të jetë në formën e imazhit dhe tekstit, në formë video ose audio.

Mesazhi mediatik ↘ Përmbajtje/informacion që transmetohet përmes kanaleve mediatike, nga dërguesi tek marrësi.

Emotikone ↘ Përshkrim tipografik i shprehjes së fytyrës përmes përdorimit të shkronjave, numrave dhe shenjave të pikësimit për të përfaqësuar një ndjenjë (për shembull, lumturi nëpërmjet një buzëqeshjeje, trishtim nëpërmjet vrenjtjes së fytyrës, dashuri nëpërmjet zemrës).

GIF ↘ (Graphics Interchange Format) – Format grafik për shkëmbimin e imazheve në internet në kohëzgjatje prej 5 deri në 10 sekonda. GIF-et janë kryesisht imazhe të animuara dhe përdoren për të ndarë shaka dhe emocione.

Meme ↘ Fotografi interesante dhe kryesisht argëtuese, vizatim ose video e shkurtër e kombinuar me tekst, e cila përhapet shpejt midis përdoruesve të internetit.

¹ Terma të shumëfishtë të përfshirë në këtë Listë të nocioneve janë në përputhje me Fjalorin për Edukim Mediatik të përgatitur nga Instituti i Studimeve të Komunikimit (2023), si dhe me "Doracakun për trajnues për Edukim Mediatik: Mësojmë të njohim", të përgatitur në kuadër të Projektit të USAID-it për Edukimin Mediatik "Të rinjtë mendojnë". Fjalori është menduar për mësimdhënësit, ndërsa shpjegimi dhe përkufizimi i termave nuk duhet të jetë pjesë e orës mësimore me nxënësit në klasë.

**PROPOZIM-ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA FUSHA**

**E EDUKIMIT
MEDIATIK DHE
KULTURËS
MEDIATIKE**

KLASA II



LLOJET E

MEDIAVE

(1 orë)



Ora 1

Llojet e mediave dhe mesazhet mediatike

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- Paraqet burimet e mesazheve dhe përmbajtjes mediatike (revistë, radio, televizion, billboard, poster, fletëpalosje, media onlajn, telefon celular).

Burime për orën mësimore:

- revista;
- poster;
- fletëpalosje;
- fotografi/ilustrime;
- pajisje (në varësi të pajisjeve të shkollës – radio, televizor, kompjuter, billboard, tabelë inteligjente [smartboard]).

12

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Cilat janë mesazhet mediatike (realizimi 10 minuta)

Për të prezantuar temën, mësimitdhënësi inkurajon diskutimin me nxënësit duke parashtruar disa pyetje, si:

- Si kuptoni për një ngjarje, lajm apo informacion që ju intereson? Për shembull, si e zbuluat se ekipi maqedonas i futbollit do të luajë një lojë të rëndësishme sonte?
- Si të informoheni në cilën orë fillon mësimi më 1 shtator në shkollën tonë?
- Si e dini kur ka shfaqje të re për fëmijë?
- Si dallojnë informacionet që arrijnë te ne nga burime të ndryshme (TV, radio, revista, media onlajn)?

Pas përgjigjeve të dhëna për nxënësit, mësuesi arrin në përfundimin se informacioni dhe përmbajtja i transmetohen audiencës nëpërmjet simboleve, imazheve, teksteve, tingujve, muzikës dhe quhen mesazhe mediatike.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Llojet e mediave (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi paraqet shembuj të mediave të ndryshme (revistë, radio, televizion, internet, billboard, poster, fletëpalosje), ndërsa nxënësit duhet të përcaktojnë për cilat lloje të mediave bëhet fjalë.

Pastaj, mësimitdhënësi bën pyetje udhëzuese për të cilat nxënësit diskutojnë:

- Në çfarë mënyre/përmes cilës formë mund të transmetohet përmbajtja në mediat e specifikuar?
- Si transferohet përmbajtja në revista dhe libra? Po në radio dhe televizion?
- Në çfarë forme mund të transmetohet përmbajtja përmes internetit?
- A mund të përmendni shembuj të tjerë të mediave?

Nxënësit së bashku me mësimdhënësin arrijnë në përfundimin se mesazhet, përmbajtja dhe informacioni mediatic transmetohen përmes mediave. Mësimdhënësi bën një rezymë dhe tregon se ka media të shtypura, vizuale, media onlajn dhe se ato transmetojnë përmbajtje përmes tekstit, fotografisë, imazheve, zërit, videos dhe përmbajtjeve të tjera vizuale. Të gjitha janë burime informacioni.

Pjesa përmblylëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Gjithçka është mesazh (realizimi 10 minuta)

Nëpërmjet një prezantimi vizual, mësimdhënësi u tregon nxënësve përmbajtje nga/me lloje të ndryshme të mesazheve mediatiche (tekst, foto, video dhe tinguj) të destinuara për media të ndryshme (revistë, radio, televizion, billboard, poster, fletëpalosje, internet).

Më pas, nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet detyra të përcaktojnë se në cilën media mund të publikohet përmbajtja e paraqitur dhe të shpjegojnë pse mendojnë kështu (për shembull, tregimet mund të lexohen në libra, libra me figura, të shihen në filma si versione të ekranizuara, por edhe të shihen, lexohen ose dëgjohen në internet; muzika mund të dëgjohet në radio, por edhe në internet dhe në celular; mund të shohin reklama në gazeta, në televizion, por edhe në vitrinat e dyqaneve).



Reflektim

- Çfarë punuam në orën e sotme?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?

LLOJET E

MESAZHEVE

MEDIATIKE

- RAPORTIM,

UDHËZIM,

REKLAMË

(2 orë)



Ora 1

Mesazhe mediatike për media, udhëzime dhe mesazhe reklamuese

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësjë:

- ↳ Bën dallim mes mesazheve mediatike për raportim, udhëzim dhe reklamim;
- ↳ Nxjerr informacione të rëndësishme nga lloje të ndryshme të mesazheve mediatike.

Burime për orën mësimore:

- ↳ fletë mësimore;
- ↳ karta të punuara prej kartoni me ngjyrë;
- ↳ kompjuter dhe projektor LCD ose tabelë inteligjente;
- ↳ gazeta;
- ↳ revista për fëmijë;
- ↳ flomasterë;
- ↳ hamer;
- ↳ gërshtë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Llojet e mesazheve mediatike (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi e fillon orën me një diskutim hyrës përmes pyetjeve të mëposhtme:

- ↳ Kur blejmë aparat për të bërë akullore, ku mund të lexojmë dhe të mësojmë se si ta përdorim atë?
- ↳ Kur duam të shkojmë në një koncert/kinema apo në një ndeshje sportive, ku mund të informohemi se kur dhe ku do të zhvillohet ngjarja?
- ↳ Si informohemi se cila shfaqje për fëmijë në kinema luan këtë fundjavë?
- ↳ Si informohen prindërit se kur do të mbahet mbledhje prindërore në shkollën tonë?
- ↳ Pse reklamohen lodrat për fëmijë?

Pas diskutimit, mësimdhënësi dhe nxënësit arrijnë në përfundimin se kur duam të zbulojmë informacione për një ngjarje që duhet të ndodhë, zakonisht pyesim nëse ka një njoftim në lidhje me të; kur duhet të përdorim një produkt për herë të parë, mund të lexojmë në manual se si përdoret, ndërsa reklamën janë përmbajtje që synojnë të na informojnë dhe të na bindin se një produkt është i mirë ose i dobishëm.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Analiza e mesazheve mediatike (realizimi 25 minuta)

Mësimdhënësi përgatit një panel mesazhesh që është i ndarë në tri pjesë: mesazhe mediatike për raportim, mesazhe për dhënien e udhëzimeve dhe mesazhe reklamuese. Ai/ajo u jep nxënësve, të ndarë në grupe, shembuj të mesazheve të shkurtra mediatike (Fletë Pune 1, pa specifikuar llojin e mesazhit mediatik). Për të përcaktuar llojin e mesazhit mediatik, nxënësit duhet të nxjerrin informacionin e rëndësishëm nga çdo mesazh. Për këtë qëllim, mësuesi u bën atyre pyetje udhëzuese:

- A ka qëllim ky mesazh të përcjellë ndonjë informacion? Për çfarë informon mesazhi?
- A ofron ky mesazh udhëzime se si të bëhet/si funksionon diçka/si të luhet një lojë?
- A përfaqëson (promovon) ky mesazh ndonjë produkt ose rekomandon diçka për të blerë?

Nxënësit diskutojnë dallimet në përmbajtje dhe mënyrën e paraqitjes së tri llojeve të mesazheve. Të ndarë në grupe, nxënësit duhet të analizojnë mesazhet dhe të nxjerrin informacione të rëndësishme nga secili prej tyre, në bazë të të cilave do të kategorizojnë mesazhet sipas llojit – njoftimit, udhëzimit dhe reklamës. Pastaj, një përfaqësues nga grupi “var” çdo mesazh në panel në seksionin e njoftimeve/udhëzimeve ose reklamave.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Karakteristikat kryesore të mesazheve të ndryshme mediatike (realizimi 5 minuta)

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve duke bërë rezyme të përmbajtjes mësimore:

- Çfarë informacioni përmbanin mesazhet që lexuam/pamë?
- Nga cilat media i lexuam/pamë mesazhet?
- Çfarë gjuhe mediatike është përdorur për të krijuar mesazhet: për raportim, për të dhënë udhëzime dhe për reklamim (simbole, ngjyra, tekst, tingull, fotografi etj.)?

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kthehen në panel në fillim të aktivitetit dhe kontrollojnë nëse i kanë vendosur kartat në kategorinë e saktë të treguar në panel. Ata konkludojnë bashkërisht për karakteristikat e mesazheve mediatike për raportim, për dhënien e udhëzimeve dhe për reklamim.



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?



Fletë Pune 1 - Fletë diskutimi

1 Shembulli - Njoftimi

Zgjedhim shkollën filllore të dekoruar më mirë!²

Këtë vit, ekipi i “Deca.mk” vendosi të zgjedhë shkollën filllore të dekoruar më mirë së bashku me lexuesit.

Na dërgoni fotografi, maksimumi 5, të korridorit të shkollës ose dekorimeve të jashtme. Për çdo shkollë, do të publikojmë një tekst të veçantë me fotografitë, dhe ajo shkollë që do të ketë më shumë pëlqime nga lexuesit, do të marrë një paketë produktesh nga “Bota e Bibit” për të pasuruar bibliotekën e saj shkollore.

Na dërgoni fotografitë tuaja, informacione për shkollën dhe telefonin e kontaktit në redakcija@fakulteti.mk.

2 Shembulli - Raportimi

Shfaqja operistike për fëmijë “Punëtorja e babadimrit” në OBM³



² Burimi: Deca.mk, <https://deca.mk/izbirame-najdobro-ukraseno-osnovno-uchilishte/>

³ OBM, <https://tinyurl.com/4yp8sz3p>

Me rastin e festave të ardhshme, Opera dhe Baleti i Maqedonisë po përgatit një shfaqje të veçantë të Vitit të Ri për fëmijë, "Punëtorja e Babadimit".

Shfaqja do të luhet në Skenën e Vogël në Operën dhe Baletin e Maqedonisë të martën, më 20 dhjetor, me fillim në ora 18:00, ndërsa çmimi i biletës është 150 denarë.

3 Shembulli - Njoftimi

Të dashur nxënës,

Të mërkurën, më 11.5.2025, nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën do të shkojnë në një ekskursion pranveror njëditor në parkun pyjor Gazi Baba. Nisja është në orën 8:00, ndërsa kthimi në orën 13:00. Nxënësit duhet të marrin me vete ushqim dhe ujë, si dhe mjete për të luajtur: topa, raketa tenisi, litar kërcimi etj.

4 Shembulli – Udhëzim

Udhëzime për të luajtur lojën "Storytelling /Kubi i përrallës"

1. Merrni një fletë në të cilën është vizatuar një kub;
2. Priteni fletën dhe montoni figurën e kubit;
3. Në secilin katror të kubit, ngjitni nga një fotografi nga fleta e punës që do ta shpërndajë mësimdhënësi, e që ka të bëjë me ndonjë storje;
4. Krijoni një histori të lidhur me miniatyrën, së bashku me shokun me të cilin jeni ulur;
5. Tregoni historinë me shokun tuaj, para gjithë klasës.

5 Shembulli – Udhëzim

Udhëzime për përgatitjen e maskës për 1 prill⁴

- a. Priteni maskën (nëse përdorni një shabllon);
- b. vizatoni rrrathë për sytë;
- c. pritni vrimat për sytë;

⁴ Burimi: "Besoni në veten tuaj dhe luani së bashku", Funny Animal Masks, https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2022/06/1.-face-vol.-1_ma.pdf, f. 17.

- d.** lyeni maskën;
- e.** dekoroni maskën;
- f.** bëni vrima për shiritin e gomës dhe lidhni shiritin e gomës;
- i.** shkruani emrin tuaj në maskë.

6 Shembulli – Udhëzim

Udhëzime për montimin e një lodre

- 1.** Hiqni të gjitha pjesët e kinder-vezës (ka pesë pjesë);
- 2.** Shikoni secilën pjesë të skemës ku duhet të qëndrojë;
- 3.** Rregulloni pjesët e lodrës siç tregohet në vizatimin e mëposhtëm.

7 Shembulli – Reklamë

Zbritje e madhe për muajin shtator për çantat e shpinës!

Na vizitoni çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 19:00!

8 Shembulli – Reklamë

Dyqani “Ciklo”: “Biçikletat më të shpejta në qytet shiten këtu! Zgjedhje e madhe për të gjitha moshat!”

9 Shembulli – Reklamë

Dyqani i ëmbëlsirave “Kremçe” – Akullorja më e mirë që keni provuar ndonjëherë!

INTERPRETIMI

DHE PËRDORIMI I

PËRMBAJTJEVE

MEDIATIKE

(3 orë)



Ora 1

Identifikimi i mesazheve kryesore në përmbajtjen mediatike

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësjë:

- Identifikon një mesazh kyç në përmbajtjen e mediave tekstuale të shkruara me shkronja me madhësi/trashësi të ndryshme dhe/ose me ngjyra të ndryshme;
- Identifikon një mesazh kyç në përmbajtjen mediatike me ilustrime sipas madhësisë, pozicionit dhe ngjyrës së objekteve të shfaqura.

Burime për orën mësimore:

- fletë pune;
- karton, hamer, fletë me ngjyra, letër që zgjatet etj.;
- shumëllojshmëri të veglave për shkrim dhe vizatim të madhësive dhe trashësive të ndryshme;
- enë për ngjyrosje;
- fletë mësimore me përmbajtje mediatike tekstuale;
- kompjuter dhe projektor LCD ose tabelë inteligjente;
- gazeta;
- revista për fëmijë;
- ilustrime të ndryshme;
- gërshtë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Si e tërheq vëmendjen tonë posteri? (realizimi 5 minuta)

Mësimdhënësi tregon postera që tregojnë tema të përshtatshme për moshën e fëmijëve (postera/pllakata nga filma, festivale për fëmijë, ngjarje mjedisore, aktivitete sportive, aktivitete shkollore etj.) dhe hap një diskutim me nxënësit në lidhje me përmbajtjen e tyre:

- Kujt i referohen posterat?
- A ka shumë apo pak informata?
- Ku dhe si janë shkruar fjalët?
- Pse disa fjalë janë me shkronja/numra më të mëdhenj dhe disa me numra më të vegjël?
- A ndryshon shkrimi (shkrimi i dorës) i fjalëve të caktuara?

Nxënësit arrijnë në përfundimin se shkronjat, ngjyrat, imazhet dhe ilustrimet e tjera në postera u përdorën për të nxjerrë në pah një mesazh të rëndësishëm që posteri duhet t'u përcjellë atyre për të cilët është menduar.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përcaktimi i mesazheve kryesore (realizimi 20 minuta)

Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fjalë nga një tekst mediatik (si në shembujt e mësipërm). Secili grup ngjyros fjalët që i konsideron të rëndësishme në atë fjalë. Secili grup duhet të lexojë fjalët dhe të shpjegojë pse i ka ngjyrosur pikërisht ato fjalë si më të rëndësishmet e fjalisë që ka lexuar.

Shembulli 1: Në rrugën kryesore në qytet, u organizua **një garë e pazakontë** në të cilën **morën pjesë 100 babadimra**.

Shembulli 2: **Dieta e shëndetshme e fëmijëve** është shumë e rëndësishme dhe duhet të përfshijë **proteina, fruta, perime dhe drithëra**

Shembulli 3: Në **kopshtin zoologjik në Shkup**, muajin e kaluar **kanë lindur dhjetëra** këlyshë të llojeve të ndryshme.

Shembulli 4: **Këlyshët e vegjël luanë në kopshtin zoologjik të Shkupit** u quajtën **Luna, Ana dhe Hana**, sipas propozimeve të dërguara nga numri më i madh i qytetarëve.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Shkruajmë eko-mesazhe (realizimi 15 minuta)

Nxënësit e ndarë në grupe të vogla kanë për detyrë të krijojnë eko-mesazhe të shkurtra, të cilat mund të përmbajnë vizatime, simbole ose disa fjalë kyçe. Kështu, ata duhet të përdorin madhësi të ndryshme të shkronjave kur shkruajnë termat që duan t'i theksojnë më shumë ose të ngjyrosin me ngjyra të ndryshme. Për këtë aktivitet, nxënësit mund të përdorin karton, hamer, fletë me ngjyra, letër zgjatëse etj.; një shumëllojshmëri të veglave për shkrim dhe vizatim me madhësi dhe trashësi të ndryshme; pajisje për ngjyrosje etj.

Mesazhet e përgatitura vendosen nga nxënësit në vende të ndryshme në klasë dhe secili grup shpjegon mesazhin para gjithë klasës. Nxënësit komentojnë përmbajtjen e mesazhit dhe mënyrën/formatin e theksimit të tij dhe në këtë mënyrë japin një shpjegim të asaj që është kryesore, që duhet të kuptohet prej tij.



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?

Ora 2

Njohja e ikonave digjitale (emotikon, gif dhe meme) në aplikacionet celulare dhe kompjuterike

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësjë:

- ↘ e njeh rëndësinë e ikonave digjitale (emotikon, gif dhe meme) në aplikacionet celulare dhe kompjuterike.

Burime për orën mësimore:

- ↘ hamer;
- ↘ fletë pune;
- ↘ enë për vizatim dhe ngjyrosje;
- ↘ letër me ngjyrë;
- ↘ flomasterë;
- ↘ kompjuter;
- ↘ tabelë inteligjente.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Si ndihem kur... (realizimi 10 minuta)

Çdo nxënësi i jepet një fletë pune për të përshkruar se si ndihen në situata të ndryshme (Fletë Pune 1). Mësimdhënësi lexon fjalitë një nga një, ndërsa secili nxënësi vizaton një emotikon bazuar në emocionet që ata ndiejnë.

Në fund të aktivitetit, nxënësit ndajnë vizatimet e tyre dhe shpjegojnë se çfarë do të thotë vizatimi.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Kuptimi i emotikoneve, gifëve dhe memeve (realizimi 15 minuta)

Me një prezantim me video, mësimdhënësi shfaq shembuj të ikonave digjitale (emotikon, gif dhe meme) të përdorura në aplikacionet celulare dhe kompjuterike. Nxënësit shpjegojnë kuptimin e ikonave digjitale të shfaqura dhe diskutojnë se ku dhe për çfarë mund të përdoren.

Mësimdhënësi pastaj lexon maksimumi 3 shembuj, të cilët nxënësit në fletoret e tyre duhet t'i paraqesin duke përdorur një ose më shumë emotikon (të cilët tashmë janë të njohur ose mund t'i shpikin të tyre). Disa nga shembujt mund të jenë si më poshtë:

- ↘ Kur bën shumë vapë, unë dhe prindërit shkojmë në det.
- ↘ Më pëlqen të ha akullore.
- ↘ Gëzuar ditëlindjen mami, të dua më shumë në botë!
- ↘ Ka shumë kafshë të egra në pyll.
- ↘ Dua shumë dhurata nga babadimri.
- ↘ Kur jam në natyrë, më pëlqen të bëj fotografi me aparat fotografik ose telefon celular.

Pasi disa nxënës paraqesin përshkrimet e tyre për secilën nga fjalitë, së bashku me mësuesin tregojnë nëse ka dallim midis emotikonëve që janë përdorur për të ilustruar të njëjtat deklarata. Së bashku me mësuesin, konkludohet se secili prej nesh i kupton dhe i përjeton gjërat ndryshe, prandaj mund t'i paraqesim ose t'i ilustrojmë ndryshe.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Një fotografi, 1000 fjalë (realizimi 15 minuta)

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr të njëjtën listë të emotikonëve të ndryshëm dhe një temë për të cilën do t'i përdorin (është mirë që dy grupe të punojnë në të njëjtën temë). Tema mund të jenë Ruajtja e natyrës; Dita e Gruas – 8 Marsi; Dita e Vitit të Ri dhe Babadimri i Vitit të Ri etj., në varësi të periudhës së vitit kur realizohet ora mësimore. Nxënësit duhet të zgjedhin emotikon për të paraqitur temën e një posteri, pa përdorur tekst, duke zgjedhur vetëm ato që u pëlqejnë më shumë dhe besojnë se janë më të përshtatshmet për paraqitjen e temës. Nxënësit presin emotikonët dhe bëjnë një poster. Secili grup paraqet posterin, dhe grupet e tjera përpiqen të "interpretojnë" përmes emotikonëve se për çfarë bëhet fjalë në poster. Pastaj, ata diskutojnë se për të "dërguar" të njëjtin mesazh në të njëjtën temë, të gjithë mund të përdorin imazhe/emotikone të ndryshëm, pasi mund ta shprehin atë me fjalë të ndryshme, në mënyrën e tyre.

Në fund, mësuesi dhe nxënësit diskutojnë nëse mund ta kuptojmë mirë dhe në mënyrë të përshtatshme njëri-tjetrin duke komunikuar me emotikone. Së bashku ata arrijnë në përfundimin se ka situata kur është e përshtatshme të përdoret kjo mënyrë komunikimi (kur duam të komunikojmë diçka shpejt ose kur komunikojmë me miqtë përmes rrjeteve sociale), por komunikimi me fjalë është më i qartë



Reflektim

- Çfarë punuam në orën e sotme?
- Si u ndiet kur iu përgjigjët pyetjeve të parashtruara?
- Çfarë mësuat?
- Si mund ta përdorni atë që keni mësuar në jetën tuaj të përditshme?



Fletaë Pune 1 - Si ndihem kur...

- Jam i/e lumtur kur festoj ditëlindjen.
- Isha shumë i/e trishtuar kur u humb kotelja.
- Një fëmijë grisi rrjetën e koshit.
- Mësuesja më lavdëroi në orën e matematikës.
- Një fëmijë më shtyu ndërsa prisja të pi ujë.
- E lëndova krahun dhe më dhemb shumë.
- Natën kthehem në shtëpi vetëm, nëpër një rrugë të errët.



Ora 3

Krijimi i përmbajtjeve për të përcjellë një mesazh mediatik

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- - krijon fjalë kyç dhe fraza dhe zgjedh ilustrime të përshtatshme dhe ikona digjitale si bazë për një mesazh mediatik.

Burime për orën mësimore:

- copa letre në të cilat janë shkruar një ose dy fjali për avantazhin e të jetuarit në fshat;
- fletë letre;
- shumësia me ngjyra, markera, ngjyra uji;
- ngjytëse;
- hamerë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përparësitë e të jetuarit në fshat (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi u ndan nxënësve fletë dhe në secilën prej tyre shkruhet një avantazh i të jetuarit në fshat (ajri i pastër, ushqimi i bërë në shtëpi, afërsia me natyrën, afërsia me kafshët shtëpiake, hapësira e lirë për të luajtur). Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup tërheq nga një copë letër. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të mendojnë se si avantazhin mund ta paraqesin para të tjerëve për të tërhequr më shumë njerëz të vizitojnë fshatrat ose të jetojnë në fshat.

Nxënësit kanë për detyrë të bëjnë përmbajtje mediatike duke përdorur ilustrime, tekste, deklarata të regjistruara nga vizitorët e fshatit, deklarata nga banorët e fshatit etj., të cilat do të tërheqin më shumë njerëz në fshatra.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Krijimi i një mesazhi reklamues (realizimi 25 minuta)

Nxënësit, të ndarë në grupe, punojnë detyrën – reklamojnë “përparësinë” e të jetuarit në fshat. Brenda grupit, zgjedhin fjalë kyç ose fraza ose shprehje për të krijuar një mesazh reklamues rreth “avantazhit” (p.sh. Shijoni ushqimin e shëndetshëm! Lojëra pa kufij! Ajri i pastër është vetëm këtu në fshat! etj.) Më pas, secili grup shpik ilustrime të përshtatshme dhe ikona digjitale

p.sh.



etj.

që do të jenë pjesë e posterit reklamues. Nxënësit e përgatisin posterin reklamues nëpërmjet një vizatimi, fotografie, fotografi të prera etj., nëpërmjet ikonave digjitale dhe një mesazhi kuptimplotë. Në fund, secili grup prezanton atë që ka punuar para gjithë klasës dhe bien dakord se si dhe ku të vendosin posterat e përgatitura në shkollë.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Mesazh reklamues me fotografi dhe fjalë (realizimi 5 minuta)

Mësimdhënësi hap diskutim rreth reklamave, çfarë përbën një reklamë, çfarë tërheq vëmendjen kur shikohet një reklamë. Nxënësit shprehin mendimet e tyre duke analizuar dhe interpretuar reklamat. Në fund, të udhëhequr nga mësimdhënësi, nxënësit konkludojnë se *fjalët kyç* dhe *ilustrimet* janë baza për të tërhequr vëmendjen e dikujt dhe për të dërguar një lloj mesazhi.



Reflektim

- Çfarë punuam sot?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?


KRIJIMI I

MESAZHEVE DHE

PËRMBAJTJEVE

MEDIATIKE

(2 orë)



Ora 1

Si të zgjidhni përmbajtjen për të përcjellë një mesazh?

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- zgjedh përmbajtje mediatike për prezantim të koncepteve dhe përpunim të temave.

Burime për orën mësimore:

- karta në të cilat janë shkruar emrat e disa festave;
- shkumësa me ngjyra, markera, ngjyra uji;
- ilustrime;
- ngjitës;
- fletë letre;
- hamerë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Pushimet familjare (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për festat që festohen në mjedisin e tyre. Nxënësit përmendin lloje të ndryshme të festave dhe kremtimeve, si dhe mënyra për të ftuar njëri-tjetrin në këto ngjarje. Ata arrijnë në përfundimin se kartat/kartolinat për urim shpesh përdoren si ftesa në ngjarje të ndryshme, megjithatë, mund të përdoren edhe media të reja, të tilla si një ftesë përmes mesinxherit ose mesazh përmes telefonit celular.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përgatitja e ftesave (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi u jep nxënësve karta me ngjyra të ndryshme që ata do t'i përdorin për të përgatitur ftesa për të marrë pjesë në një festë familjare. Në çdo kartolinë shkruhet emri i llojit të festës familjare (ditëlindja, dita e emrit, dasmë, kremtim).

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup tërheq nga një letër. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të mendojnë se cilat fjalë kyç ose shprehje, LCD ose ilustrime të përshtatshme paraqesin temën e shkruar në kartë dhe t'i përdorin ato në një mënyrë krijuese për të përgatitur një ftesë për festën që është shënuar në kartë.

Mësimdhënësi tregon shembuj për festimin e një ditëlindjeje – kartolina ose ilustrime me numra, me kapela, konfeti; për festimin e Vitit të Ri – kartolina me babadimër, me pemën e Vitit të Ri, drerë, dhurata etj.; për një martesë, përdoren imazhe me të një torte dasme, pëllumba etj. Pas përfundimit të punës, nxënësit prezantojnë punimet e tyre dhe shpjegojnë kuptimin e imazheve dhe ilustrimeve që kanë përdorur.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Festojmë së bashku (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi inkurajon nxënësit të diskutojnë aktivitetin e realizuar në pjesën kryesore të orës mësimore duke përdorur pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë fjalë keni përdorur për të shkruar një mesazh/përmbajtje në kartë?
- Çfarë informacioni duhet të përmbajë një ftesë për një festë?
- Çfarë ilustrime/fotografi/miniatura keni përdorur për përmbajtjen e fletëpalosjes/posterit/broshurës?
- Si i zgjodhët?
- Në çfarë material i keni punuar produktet? Pse vendosët të punoni në këtë mënyrë?
- Çfarë mendoni, nëse nuk zgjedhim fotografitë e vogla përkatëse dhe fjalët e duhura, a mendoni se mund të na keqkuptojnë?
- Çfarë përfundojmë se është më e rëndësishme kur krijojmë një mesazh (në një kartë, në një poster, në një broshurë...)? Pse është e nevojshme të zgjidhni një kombinim të përshtatshëm të fjalëve, ilustrimeve, simboleve etj.

Nxënësit, së bashku me mësimdhënësin, arrijnë në përfundimin se zgjedhja e duhur e imazheve, fjalëve dhe përmbajtjeve të tjera është shumë e rëndësishme për të përcjellë mesazhin në një mënyrë të kuptueshme.

Shënim:

Aktivitetet e parashikuara do të realizohen plotësisht në kohëzgjatjen e dy orëve mësimore. Kjo përmbajtje mund të integrohet gjithashtu me lëndët e Arsimit Figurativ dhe Shoqëria.



Reflektim

- Çfarë punuam në orën e sotme?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?

Ora 2

Krijimi i mesazheve mediatike

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësjja:

- Zgjedh përmbajtje mediatike për prezantim të koncepteve dhe përpunim të temave;
- Përpilon mesazh të shkurtër mediatik në formën e një reklame, udhëzimi dhe informacioni.

Burime për orën mësimore:

- prerje nga përmbajtja mediatike;
- shumësia me ngjyra, markera, ngjyra uji;
- ilustrime;
- ngjytës;
- fletë letre;
- hamerë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Asociacione (realizimi 10 minuta)

Nxënësit marrin disa fjalë kyç që janë pjesë e jetës së tyre të përditshme dhe thonë fjalë që i lidhin me fjalën e dhënë. Për shembull, për termin çamçakëz, mund të sugjerohen asociacionet e mëposhtme: pikante, me shije shalqiri, pa shije, tullumbace; për termin lëng, asociacione të mundshme mund të jenë: portokall, i gazuar, i shtrydhur, freskues, i ftohtë etj.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Bëjmë reklama, udhëzime dhe informacione (realizimi 20 minuta)

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup ka për detyrë të bëjë një reklamë, ose të hartojë një udhëzim ose informacion për një ngjarje (me disa fjali). Grupi që duhet të bëjë një reklamë duhet të mendojë për fjalët e duhura për çamçakëzin e preferuar, lëngun, kroasantin dhe të ngjashme. Grupi përgjegjës për udhëzimin duhet të mendojë për hapat për të bërë një fletëz në formë erashke nga letra. Grupi i tretë ka për detyrë, me disa fjali, të hartojë një njoftim për prindërit për një mbledhje prindërore që do të mbahet javën e ardhshme.

Pas përfundimit të aktiviteteve, grupet shpjegojnë përmbajtjen e tyre mediatike.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Fjala kyç në mesazhet mediatike (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi e ndan tabelën në tri kolona (mund të përdoret një flipçart ose një hamer, i cili në fund të aktivitetit do të varet në një vend të dukshëm në klasë) dhe në secilin prej tyre shkruan një fjalë kyç që i referohet një prej mesazheve mediatike që nxënësit duhet të paraqesin – njoftim, reklamë ose udhëzim. Një përfaqësues nga secili grup duhet të shkruajë maksimumi tri fjalë kyç ose terma/shprehje/data që përfaqësojnë më së miri mesazhin që ata duan të përcjellin ose të paraqesin procesin përmes një ilustrimi/vizatimi. Nxënësit që kanë punuar reklamë duhet të vizatojnë ose të shkruajnë në tabelë një ilustrim interesant që lidhet me produktin që ata përfaqësojnë (p.sh. çamçakëz, lëng); nxënësit që përgatisin doracak përdorimi për një pajisje/objekt duhet të shkruajnë tri hapa kryesorë se si përdoret pajisja (p.sh. përgatitja e lëngut: 1. Marrim një shtrydhëse frutash; 2. Vendosim një portokall në të; 3. Shtypim butonin START); nxënësit që duhet të përgatisin një njoftim mund të shkruajnë datën dhe orën kur duhet të kryhet një aktivitet ose ngjarje e caktuar.



Reflektim

- Çfarë punuam në orën e sotme?
- Çfarë ishte më interesante për ju?
- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?

